



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Sqarim rreth Letër konfirmimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkuara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Në Pasqyrat Vjetore Financiare janë identifikuar gabime materiale në shpalosjen e informatave financiare që kanë të bëjnë me: mbivlerësim të salldos së obligimeve të papaguara për 2,313,000€, nënvlerësim i pasurive jokatipale (nën 1,000€) për 75,511€, nënvlerësim i salldos së detyrimeve kontigjente për 454,473€, mbivlerësim të salldos së të hyrave vetanake për bartje për 1,224€. Po ashtu, Ministria nuk kishte paraqitur në një aneks/shtojcë të veçantë shpenzimet për menaxhimin e pandemisë Covid-19.
- B1 Ministria nuk e kishte regjistruar projektin “Konsolidimi dhe inventarizimi i tokave bujqësore në Republikën e Kosovës” në vlerë prej 1,337,900€ në regjistrin kontabël të pasurive dhe për këtë vlerë është nënvlerësuar regjistri i pasurisë. Ky projekt ishte realizuar gjatë periudhës 2017-2021. Po ashtu, disa nga pronat e Institutit Bujqësor të Kosovës ende nuk kontrollohen dhe shfrytëzohen nga IBK.
- B2 Ministria kishte kryer pagesë në vlerë prej 103,710€ në kategori ekonomike jo adekuate si rezultat i planifikimit jo të duhur të buxhetit për projektin “Konsolidimi dhe inventarizimi i tokave bujqësore në Republikën e Kosovës”.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit.

Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

A2 Ministria kishte bërë kontrolle Ex-Post për monitorimin e implementimit të projekteve të zhvillimit të bujqësisë, mirëpo deri në përfundimin e vitit 2021 nuk kishte ndërmarrë veprime konkrete për kthimin e mjeteve nga përfituesit.

B3 Në tri mostra të testuara me vlerë totale prej 170,883€ kishte vonesa në pagesën e obligimeve. Vonesa janë identifikuar po ashtu, edhe në tri pagesa tek grantet në vlerë prej 175,704€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështjet kyçe të auditimit

Çështjet kyçe të auditimit në auditimin e Pasqyrave Financiare të MBPZhR për 2021 ishin si më poshtë:

1. Përkundër rekomandimit të vitit të kaluar, Ministria deri në fund të vitit nuk kishte arritur që t'i paguaj të gjithë fermerët dhe si pasojë vlera e obligimeve të papaguara ndaj fermerëve ishte 3,037,679€. Prej tyre për pagesa direkte (biznese) ishte 724,679€ dhe për përfitues individual ishte 2,313,000€ (vlerë kjo variable për shkak se aplikacionet ishin në proces të kontrolles administrative dhe terren). Mbetja e obligimeve të pagesat direkte ka rrjedhë për shkak të aprovimit të vonshëm të Programit. Ky fakt ka reflektuar vonesë tek të gjithë hapat e subvencionimit, që nga kontrolli administrativ, vlerësimi i aplikacioneve, procedura të

kontrollit në teren deri te finalizimi i pagesës duke marrë parasysh se aplikimi i fermerëve është bërë në muajin shtator me zgjatje të afatit deri me 05 tetor 2021. Sidoqoftë, Ministria për vitin pasues ka bërë planifikimin buxhetor për të shlyer obligimet e mbetura dhe e njëjta shumë është aprovuar në buxhetin e vitit 2022 për subvencione dhe transfere. Deri në kohën sa ne ishim në auditim ishin shlyer obligime nga 2021 prej 3,228,630€.

Çështje tjera

- 1 Programi për Pagesa Direkte – Subvencione ka të bëjë me pagesat e dhëna drejtëpërdrejtë fermerit dhe ka për qëllim përkrahjen financiare për shumicën e kulturave bujqësore. Vitet e fundit ne kemi tërhequr vëmendjen e Ministrisë me rekomandimin tonë për hartimin e programit në fillim të vitit, në mënyrë që thirrja për aplikim dhe ekzekutimi i pagesave ndaj fermerëve të bëhen brenda vitit. Pas ndarjes së mjeteve shtesë nga Qeveria, Ministria kishte përgatitur dhe shpallur Programin për 2021 me vonesë, kjo kishte ndodhur për arsye se Ministria fillimisht kishte shlyer obligimet financiare të bartura nga viti 2020 prej 41,118,270€. Ministria kishte ndërmarrë veprime që të hartoj dhe miratoj me kohë Programin për pagesa direkte duke e aprovuar në muajin mars të 2022.
- 2 AZHB është përgjegjëse për menaxhimin e procesit të subvencioneve (pagesave direkte dhe granteve) që nga aplikimi i përfituesit deri tek ekzekutimi i pagesës. AZHB që nga viti 2018 ka të formuar Drejtorinë e financave me të gjitha pozitat e nevojshme për të funksionuar si agjenci e pavarur. Pavarësisht kësaj, ekzekutimi i pagesave ende vazhdon të bëhet nga zyra qendrore e financave në ministri, duke shkaktuar vonesa në pagesë.
- 3 Nuk i kemi audituar tetë (8) mostra/pagesa të përzgjedhura për auditim nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në vlerë totale prej 910,665€, të cilat sipas dëshmive të siguruara nga MBPZhR janë në procedurë hetimore nga organet e drejtësisë.
- 4 Në kuadër të auditimit të pagesave direkte, pesë dosje të përfituesve në vlerë prej 53,721€, janë ofruar pas përfundimit të auditimit (datë 27/05/2022). Sipas Ministrisë, mos ofrimi me kohë i dëshmive të auditimit ka ndodhur për shkak të vështirësive në sigurimin e tyre, si pasojë e mungesave të hapësirave të mjaftueshme për arkivim të dokumentacionit.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë pasqyrat vjetore financiare, subvencionet dhe transferet, menaxhimin e pasurisë, etj, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me 11 rekomandime, prej tyre gjashtë (6) janë rekomandime të reja, katër (4) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Shpalosje jo të sakta në Pasqyrat Vjetore Financiare

Gjetja

Neni 1 i rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore përcakton detyrimet e raportimit, mënyrën e raportimit dhe formën e raportimit të organizatave buxhetore sipas Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Po ashtu, sipas nenit 6 - Organizatat Buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare.

Sipas Qarkores së Thesarit (MF), mbi proceset dhe afatet për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2021, pasqyrat financiare të Organizatave Buxhetore duhet të përmbajnë një seksion të veçantë (aneks) ku raportohen dhe shpalosen shpenzimet e lidhura me menaxhimin e pandemisë (Covid 19), me shpjegimet e nevojshme për transparencë buxhetore.

Nga rishikimi i PVF të ministrisë si dhe krahasimi i tyre me shënimet e SIMFK, identifikuam gabimet si në vijim:

- Tek Neni 17 (Raport për detyrimet e papaguara) - Vlera prej 2,313,000€ është prezantuar gabimisht në PVF si obligim i papaguar, ndërsa kjo vlerë ka të bëjë me vlerën e obligimeve ndaj fermerëve për pagesa direkte ndaj të cilëve ende nuk ishte bërë vlerësimi dhe nuk kanë vendime për përkrahjen financiare. Edhe pse kjo ishte sqaruar dhe shpalosur në PVF, kjo e kishte ndikuar mbivlerësimin e salldos së obligimeve për të njëjtën shumë;

- Tek Neni 18 (Detyrimet kontigjente) – Salldo e detyrimeve kontigjente ishte nënvlerësuar për 454,473€. Kjo kishte ardhur si rezultat i prezantimit të detyrimeve kontigjente të AZHB-së vetëm për vitin 2021, por jo edhe të atyre të vitit 2020;

- Tek Neni 19.3.2 (Pasuritë jo kapitale me vlerë nën 1000€) - Është prezantuar salldo e pasurive nën 1,000€ me vlerë 183,234€, ndërsa në aneks vlera e shpalosur është e nënvlerësuar për 75,511€ për pasuritë e Agjencisë së Pyjeve;

- Tek Neni 21 (Raporti për hyrat vetjake të pashpenzuara) - Tek shuma e mbetur për bartje është përfshirë edhe shuma prej 1,224€ e cila ka të bëjë me të hyrat e vitit të kaluar (2020) dhe e cila nuk bartet në vitin pasues. Sipas zyrtarit përkatës të APK-së, kjo kishte ndodhur për shkak të formatit të PVF-ve; dhe

- Ministria nuk kishte shpalosur në një aneks të veçantë shpenzimet lidhur me menaxhimin e pandemisë (Covid 19).

Ministria më datë 21.03.2022 kishte bërë kërkesë në Thesar për korrigjimin PVF-ve për çështjet e trajtuara më lartë, mirëpo ato nuk janë pranuar nga Thesari për shkak të tejkalimit të afatit të lejuar sipas Qarkores për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Gabimet në shpalosjen e informatave në PVF kanë ndodhur për shkak se informatat nga departamentet përkatëse ishin përcjellë me vonesë tek ZKF duke ndikuar që konsolidimi i informatave financiare për fushat e caktuara

të mos jetë i saktë si dhe se MBPZhR nuk i kishte zbatuar me përpikëri kërkesat e rregullores për raportim financiar dhe kërkesat e Thesarit.

Ndikimi Këto lëshime në PVF kanë rezultuar në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare në kategoritë e caktuara.

Rekomandimi A1 Ministri duhet të sigurojë se është bërë një analizë e gjetjeve që kanë ndikuar në modifikimin e opinionit të auditimit dhe të ndërmerret veprimet e nevojshme për të siguruar që mangësitë dhe gabimet e tilla të mos përsëriten gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të vitit 2022. Pasqyrat financiare të mos dorëzohen në Thesar-MFPT para se t'i nënshtrohen një rishikimi të detajuar nga ana e menaxhmentit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Ministria)

Më gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B1 - Parregullsi në regjistrimin dhe raportimin e pasurive

Gjetja Neni 6.1 i Rregullores nr.02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në Organizatat Buxhetore, përcakton që: Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Po ashtu, sipas nenit 6.3 - Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria”.

Nga auditimi i pasurisë në MBPZhR ka rezultuar se projekti “Konsolidimi dhe inventarizimi i tokave bujqësore në Republikën e Kosovës” me vlerë prej 1,491,490€ për të cilin ishte bërë pagesa e fundit në 2021 nuk ishte regjistruar në plotësi në regjistrin kontabël të pasurive. Dy pagesa në vlerë prej 153,590€ ishin regjistruar si pasuri në vijim në vitin e kaluar, ndërsa komplet vlera tjetër e projektit prej 1,337,900€ nuk ishte evidentuar në regjistrin e pasurisë së SIMFK-së, duke nënvlerësuar regjistrin për të njëjtën shumë.

Me datë 19.12.2020 është bërë pranimi nga Komisioni monitorues për këtë projekt, ndërsa gjatë ekzaminimit kemi identifikuar se ky projekt akoma nuk është vënë në përdorim nga ana e Institutit Bujqësor të Kosovës me arsyen se nuk kishin staf të mjaftueshëm për implementimin e projektit. Mos regjistrimi i pasurisë ishte ndikuar nga buxhetimi i gabuar i mjeteve nga kategoria e mallra dhe shërbimeve duke mos e trajtuar si projekt kapital.

Po ashtu, edhe gjatë këtij viti disa nga pronat tokësore të Institutit Bujqësor të Kosovës vazhdojnë të mos kontrollohen dhe shfrytëzohen nga IBK. Nga zyrtarët e IBK kemi pranuar lista të ndryshme sa i përket këtyre pronave. Për këtë arsye, ne nuk mund të japim siguri për vlerën dhe numrin e këtyre pronave, megjithëse në kuadër të Ministrisë është formuar një Komision me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm (datë 24.09.2021) për shqyrtimin dhe vlerësimin e pronave të paluajtshme të IBK-së. Kjo kishte ndodhur si shkak i kontrolleve të brendshme jo adekuate në lidhje me regjistrimin dhe raportimin e pasurisë.

Ndikimi Mos regjistrimi i plotë dhe i saktë i pasurisë në SIMFK ka ndikuar në nënvlerësimin e pasurisë në regjistrat kontabël dhe njëherit ka rezultuar në prezantim jo të drejtë të gjendjes së tyre në PFV. Po ashtu, mos regjistrimi i pasurisë rritë rrezikun që pasuria të keqpërdoret, humbet, apo tjetërsohet.

Rekomandimi B1 Ministri duhet të sigurojë se ky projekt vihet në funksion si dhe regjistrohet në regjistrat përkatës të pasurisë. Po ashtu, të sigurojë se Komisioni i formuar për shqyrtimin dhe vlerësimin e pronave të IBK-së do të finalizojë evidentimin e pasurive dhe të njëjtat të regjistrohen në regjistrat e pasurisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Ministria)

Më gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B2 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare Nr. 01/2013 shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël.

Gjatë testimit të shpenzimeve, nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve kemi vërejtur që ishte ekzekutuar pagesa e fundit për projektin "Konsolidimi dhe Inventarizimi i tokave Bujqësore në Republikën e Kosovës" në vlerë 103,710€ e cila për nga natyra i takonte kategorisë së investimeve kapitale.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i lidhjes së kontratës në vitin 2017, ku ky projekt nuk ishte buxhetuar si projekt kapital.

Ndikimi Pagesa e kryera nga kategoria ekonomike jo adekuate ka ndikuar në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve duke ofruar informata të gabuara për lexuesin. Po ashtu, duke mbi/nënvlerësuar kategoritë ekonomike adekuate për këtë shpenzim.

Rekomandimi B2 Ministri duhet të sigurojë planifikimin e buxhetit në përputhje me natyrën e projekteve në mënyrë që pagesat të realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël. Nëse planifikimet buxhetore nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e ministrisë, duhet të bëhet ridestini i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Ministria)

Më gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Dobësitë në menaxhimin e kontrolleve Ex-Post

Gjetja

Neni 3 pika 1.23 i UA nr. 05/2018 për Masat dhe kriteret e përkrahjes për zhvillim rural për vitin 2018 thekson se “Ex-post kontrolli nënkupton periudhën kohore prej tre vjetësh pas përfundimit të investimit, gjatë të cilës përfituesi duhet ta ruajë qëllimin e investimit dhe të gjitha kushtet sipas të cilave ai është përzgjedhur fitues”. Po ashtu, neni 6 pika 1.4 përcakton se periudha monitoruese është tre vjet, nëse nuk mirëmbahet investimi përfituesi obligohet ta kthejë shumën e financuar të përkrahjes publike.

Drejtorati i Kontrollit kishte realizuar kontrollin Ex-post tek 486 përfitues, me qëllim verifikimin dhe monitorimin e implementimit të projekteve të zhvillimit të bujqësisë. Me datë 12.04.2021 ishte përgatitur raporti i monitorimit nga Drejtorati i Kontrollit dhe nga ky raport ne kemi përzgjedhur 15 mostra ku theksohej se bizneset ishin jo aktive, mungonin pajisjet e përfituara si (traktori, panelet solare), pagesat e kontributeve të punëtorëve, etj. Pavarësisht parregullsive të vërejtura, Drejtorati i Autorizimit, si departament përgjegjës deri në kohën sa ne ishim në auditim (04/03/2022) nuk kishte ndërmarrë veprime, megjithatë pas kësaj që nga data 15/03/2022, AZHB-ja kishte bërë kërkesa ndaj përfituesve për përmbushjen e obligimeve ligjore dhe kontraktuale.

Sipas ministrisë, kjo kishte ndodhur për shkak të volumit të madh të punëve në Drejtoratin e Autorizimit, si dhe mungesës së stafit përgjatë vitit 2021.

Ndikimi

Mungesa e zbatimit të projekteve sipas marrëveshjes dhe mos ndërmarrja e veprimeve për kthimin e mjeteve rritë rrezikun që Ministria të paguaj për aktivitete që nuk përkojnë me objektivat e Ministrisë dhe ndikon në shfrytëzimin e tyre për qëllime tjera nga ato të synuara.

Rekomandimi A2

Ministri duhet të sigurojë që të gjitha raportet e kontrolles Ex-post të përcillen me veprime konkrete në kohën e paraparë për monitorimin e tyre. Në rastet e mos përmbushjes së detyrimeve kontraktuale nga përfituesit, të ndërmerren masat për pezullimin dhe kthimin e mjeteve siç kërkohet me marrëveshje.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Ministria)

Më gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B3 - Vonesa në pagesën e detyrimeve

Gjetja

Neni 39 i LMFPP, obligon Ministrinë për pagesën e çdo fature të vlefshme brenda afatit 30 ditësh nga data e pranimit të faturës apo kërkesës për pagim. Ndërsa afatet kohore për kryerjen e pagesave të granteve përcaktohen me udhëzuesit që i nxjerr ministria për zbatimin e programeve vjetore të aprovuara. Në bazë të këtyre udhëzuesve, pagesat duhet të bëhen 20 ditë pas marrjes së vendimit apo 40 ditë nga data e aplikimit për pagesë, përveç nëse tejkalimi i afatit bëhet për ndonjë arsye objektive.

Në tri mostra të testuara me vlerë totale prej 170,883€ kemi vërejtur se faturat nuk ishin paguar brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Vonesat variojnë nga 57 deri në 96 ditë.

Po ashtu, edhe në tri pagesa për subvencionet e dhëna përmes Programit për Zhvillimin e Bujqësisë (grantet) në vlerë totale prej 175,704€ nuk ishin respektuar afatet e përcaktuara për pagesë sipas udhëzuesit. Vonesat variojnë nga 60 deri në 79 ditë.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të dobëta në menaxhimin e buxhetit, dhe neglizhencës së zyrtarëve në pagesën me kohë të faturave. Ndërsa, tek grantet, përkatësisht subvencionet dhe transferet, vonesat në pagesa kishin ndodhur si pasojë e mungesës së stafit në Drejtoratin e Autorizimit dhe atij të Kontrollit në njërën anë dhe kohës së pamjaftueshme që nga parashtrimi i kërkesës në Zyret Regjionale të AZHB-së, kompletimit të dokumentacionit i cili duhet të përcillet në DA, kontrollit në teren deri te finalizimi i pagesës në anën tjetër.

Ndikimi

Mos kryerja e obligimeve brenda afatit të paraparë ligjor ndikon në rritjen e detyrimeve të papaguara si dhe në rritjen e mundësisë që Ministria t'i ekspozohet padive gjyqësore dhe të paguaj kosto shtesë. Për më tepër vonesat në pagesa për përfituesit e granteve mund të shkaktojnë probleme për fermerët, për shkak se të njëjtit mund të fillojnë aktivitetet dhe të hyjnë në obligime duke u bazuar në pagesat apo kompensimet që pritet t'ua bëj Ministria.

Rekomandimi B3

Ministri përmes zyrës së financave dhe drejtorive përkatëse duhet të forcojnë masat e përgjegjësive ndaj zyrtarëve financiar dhe zyrtarëve tjerë administrativ për të siguruar se të gjitha obligimet do të paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh pas pranimit të faturave, ndërsa tek subvencionet dhe transferet duhet të ndërmerren veprime për zbatimin në praktikë të afatit kohor nga kërkesa deri te finalizimi i pagesës duke e eliminuar tejkalimin e afatit për pagesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Ministria)

Më gjerësisht shih Shtojcën I

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 68,639,685€, prej tyre ishin shpenzuar 67,989,985€. Kategoria e subvencioneve dhe transfereve përbën 91% të shpenzimeve të përgjithshme të Ministrisë, që kanë të bëjnë kryesisht me pagesat direkte, grantet dhe dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore në bujqësi. Zbatimi i këtyre programeve bëhet në baza vjetore sipas Programit për Zhvillim Rural dhe Programit për Pagesa Direkte. Hartimi i këtyre politikave bëhet nga departamenti për Zhvillimin e Politikave Bujqësore dhe Tregjeve, si dhe nga Departamenti i Politikave të Zhvillimit Rural. Implementimi i tyre bëhet nga AZHB-ja, ndërsa pagesa e tyre realizohet nga departamenti i financave të Ministrisë.

Çështja A3 - Parregullsi në përlllogaritjen e vlerës për kompenzimin e dëmeve për fermerët

Gjetja Me vendim të Qeverisë nr. 20/19 (dt.14.07.2021) janë ndarë mjetet për kompenzimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore elementare në bujqësi për vitin 2020 në shumën e dëmeve prej 30%.

Ministria kishte bërë zbatimin e këtij vendimi duke paguar fermerët në bazë të listave të dërguara tek Komisioni i Ministrisë i cili kishte mandat pranimin, verifikimin dhe shqyrtimin e Raporteve të vlerësuara nga Komisionet komunale të dëmeve.

Nga 20 mostra të audituara në 6 prej tyre që i përkisnin Komunës së Istogut kemi vërejtur parregullsi në përlllogaritjen e vlerës për kompenzim, ku fermerët ishin paguar më tepër në vlerë totale prej 6,655€. Auditimi ynë ka vërejtur që në disa raste ishte rritur vlera totale e kompenzimit, ndërsa në disa të tjera ishte rritur rendimenti i dëmtuar, i cili ka ndikuar që vlera totale e kompenzimit të rritet si p.sh. (Rendimenti i dëmtuar 638.4 x Çmimi 0.51 = Vlera totale 3,255€, ndërsa llogaritja e saktë e vlerës totale është 325€).

Pasi që nuk kishte kritere të vendosura ligjore, çmimet e kulturës bujqësore dhe rendimentit janë kalkuluar bazuar në Raportin e Gjelbërt 2020⁵, ndërsa sipërfaqja ishte kalkuluar në bazë të ekzaminimit nga Komisioni komunal në mungesë të fletave poseduese. Gjatë kohës sa ne ishim në auditim, pesë përfitues kishin bërë kthimin e mjeteve në buxhetin e Ministrisë në vlerë prej 3,496€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të gabimeve gjatë përlllogaritjes së dëmeve nga Komuna e Istogut dhe mos verifikimit të duhur të listave.

Ndikimi Mbipagesat e bëra ndaj përfituesve janë pagesa të parregullta dhe dëmtojnë buxhetin e Ministrisë. Po ashtu, kjo ndikon që disa fermerë të kenë kompenzime më të ulëta në mungesë të buxhetit.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të analizojë në hollësi çështjen e mbi pagesave me rastin e kompenzimit të dëmeve për fermerët si dhe ta konsultoj zyrën ligjore dhe Komunën përkatëse duke u angazhuar në kthimin e këtyre pagesave nga përfituesit në llogarinë e buxhetit. Gjithashtu, duhet të siguroj krijimin e bazës ligjore në të cilën do të vendosen kritere të qarta të aplikimit dhe vlerësimit të dëmeve duke forcuar kontrollet para realizimit të shpenzimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Ministria)**Më gjerësisht shih Shtojcën I****Çështja A4 - Mangësi në çmimoren për miratimin e projekteve****Gjetja**

Me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm ishte formuar komisioni për hartimin e çmimorës për miratimin e projekteve të zhvillimit rural 2020 si për: Masën 101 lidhur me investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore, Masën 103 për investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe Masën 302 për diversifikimin e fermave dhe zhvillimin e bizneseve. Me rastin e miratimit të projektit, investimet dhe blerjet bazohen në Listën e investimeve të pranueshme sipas çmimores.

Gjatë auditimit të projekteve për zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural kemi identifikuar se në pesë raste çmimet e produkteve me rastin e miratimit të projektit nuk ishin të evidentuara në çmimoren e miratimit të projekteve, si: pajisje për dejonizimin e ujit me vlerë 5,000€; destiler 1000L me tri kolona me vlerë 26,000€; gjenerator avulli me vlerë 40,000€; kalibrator për tranguj 5 ton me vlerë 24,950€; makinë për mbushjen e verës Bagin box (sasi prej 3, 5 dhe 10 litra) me vlerë 20,569€.

Në mungesë të çmimeve referente, Komisioni kishte miratuar projektet sipas kërkesave të aplikuesve. Përveq kësaj, në dy raste kemi hasur se për dy produkte të njëjta (panela solare 25 kw) janë miratuar çmime të ndryshme, njëri në vlerë prej 30,000€ dhe tjetri prej 33,000€.

Mungesa e çmimeve për disa pajisje në çmimoren e miratimit të projekteve ka ndodhur si pasojë e mos hulumtimit të mjaftueshëm të tregut nga ana e Komisionit, kërkesave të larmishme të aplikuesve dhe situatës pandemike.

Ndikimi

Mungesa e disa produkteve në çmimoren e miratimit të projekteve ka ndikuar në miratimin e çmimeve për produkte bazuar vetëm në ofertat e aplikuesve, po ashtu kjo mungesë ka ndikuar që për produkte/pajisje të njëjta Ministria të paguajë çmime të ndryshme.

Rekomandimi A4

Ministri duhet të sigurojë azhurnimin e çmimores në bazë të së cilës miratohen çmimet e granteve duke bërë hulumtimin e tregut për masat përkatëse, në mënyrë që ajo të jetë më gjithëpërfshirëse dhe të mundësojë trajtim të barabartë të kërkesave nga përfituesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Ministria)**Më gjerësisht shih Shtojcën I**

Çështja A5 - Skadimi i periudhës së garancionit bankar tek grantet

Gjetja Neni 6 dhe neni 13 pika 7.5 të UA nr. 02/2020 për Masat dhe kritetet e përkrahjes për zhvillimin rural për masat 101 dhe 103 theksojnë se “Garancioni bankar duhet të sigurohet vetëm për paradhënien prej 50 % të përkrahjes publike, përkatësisht deri në vendimin përfundimtar për pagesë/pranim të pagesës ose refuzim të pagesës”.

Gjatë auditimit të granteve në katër raste⁴ kemi identifikuar se garancioni bankar në vlerë totale prej 237,250€ i ofruar nga përfituesit për mbulimin e periudhës garantuese të granteve i cili verifikon përfundimin e investimeve sipas marrëveshjes, konkretisht para marrjes së vendimit përfundimtar për pranim të pagesës, kishte skaduar para periudhës kur realizohen kontrollat në teren dhe AZHB nuk kishte kërkuar zgjatjen e afatit të garancionit.

Sipas ministrisë, kjo ka ndodhur për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme dhe volumit të madh të punëve në Drejtorinë e Autorizimit dhe të Kontrollit, ku si pasojë nuk ishte e mundur përcjellja e skadimit të garancioneve bankare.

Ndikimi Mos mbulueshmëria e garancionit bankar deri në periudhën e aprovimit apo refuzimit të pagesës së dytë të projektit rrezikon mos realizimin e grantit sipas miratimit dhe pamundëson tërheqjen e garancionit. Përveç kësaj, implikon Ministrinë në ndërmarrjen e alternativave ligjore për kthimin e mjeteve.

Rekomandimi A5 Ministri duhet të sigurojë që të ndërmerren masat/veprimet konkrete për të siguruar që garancionet bankare të ofruara nga përfituesit për paradhënien prej 50% të përkrahjes publike mbulojnë periudhën deri tek vendimi përfundimtar për pagesë apo refuzim të pagesës përfundimtare, me qëllim të marrjes së sigurisë dhe evitimit të procedurave gjyqësore me rastin e mos përmbushjes së projekteve nga përfituesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Ministria)

Më gjerësisht shih Shtojcën I

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në Raportin vjetor financiar për vitin 2021 e pasurive kapitale është 43,988,596€, pasurive jokapitale është 183,235€, si dhe e stoqeve 18,245€.

Çështja B4 - Mos harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistra të pasurisë

Gjetja Neni 19 paragrafi 4.3 i rregullores Nr. 02/2013 – për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton se: Përgjegjësi e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare është edhe “Krahasimi i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare”, si dhe neni 20 përcakton se “Organizata buxhetore duhet të bëjë vlerësimin e pasurisë jo financiar për të vërtetuar nevojshmërinë e pasurisë jo financiare për organizatën, gjendjen fizike dhe mundësinë për ta përdorur në njësitë tjera të organizatës.”

Lidhur me menaxhimin e pasurisë kemi identifikuar se në Ministri, komisionet përkatëse kanë bërë inventarizimin e pasurisë për vitin 2021, duke përgatitur raporte gjithëpërfshirëse, mirëpo nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare dhe se raportimi i pasurive në PVF ishte bërë sipas regjistrave kontabël. Përderisa, komisioni i vlerësimit në MBPZhR kishte përgatitur raportin pas hartimit të pasqyrave financiare. Si pasojë e mos-harmonizimit të regjistrat të pasurisë me shënimet e komisionit të inventarizimit, kemi identifikuar një veturë e cila në SIMFK figuron si pasuri në përdorim me vlerë të mbetur prej 10,266€, përderisa gjatë ekzaminimit fizik identifikua se ishte jashtë përdorimit (e prishur) dhe se e njëjta nuk ishte identifikuar si e tillë në raportet e komisionit të inventarizimit/vlerësimit.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontroleve të brendshme jo adekuate në lidhje me menaxhimin e pasurisë.

Ndikimi Mos harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistra të pasurisë dhe mos raportimi me kohë i komisionit të vlerësimit reflekton në mbi/nënvlerësim të gjendjes së pasurisë. Kjo rrit rrezikun që pasuria të keqpërdoret, humbet, apo tjetërsohet dhe njëherësh ndikon në prezantim jo të drejtë të gjendjes së tyre në PVF.

Rekomandimi B4 Ministri duhet të sigurojë që komisionet për inventarizimin dhe vlerësimin e pasurisë të përfundojnë punën e tyre para përgatitjes së pasqyrave financiare, si dhe të bëjnë krahasimin e të dhënave si rezultat i inventarizimit me gjendjen e pasurive në regjistrat kontabël. Mungesat, tepricat, pasuritë e dëmtuara, duhet t'i prezantojë në raport dhe të njëjtin duhet ta aprovoj menaxhmenti në mënyrë që ndryshimet të reflektohen edhe në regjistrat kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Ministria)

Më gjerësisht shih Shtojcën I

2.3.3 Të arkëtueshmet

MBPZhR në raportin vjetor financiar të vitit 2021 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 3,813,713€. Shuma prej 3,616,566€ apo 94.8% të të arkëtueshmeve të cilat i takojnë Agjencionit të Pyjeve të Kosovës ka të bëjë me operatorët që janë paditur për shfrytëzimin e pronës publike.

Çështja C1 - Mungesa e veprimeve konkrete nga Ministria për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas nenit 3 të kontratave të lidhura ndërmjet Ministrisë dhe qiramarrësve për shfrytëzimin e pronave - pagesa duhet të bëhet deri me datën 10 të çdo muaji vijues. Po ashtu, sipas nenit 6 - qiradhënësi mund ta ndërpres kontratën për qiranë në rast se qiramarrësi nuk e paguan qiranë.

Në dy raste kemi vërejtur se shfrytëzuesit e pronave nuk kishin kryer obligimet ndaj ministrisë në vlerë prej 15,200€. Edhe pse Ministria gjatë vitit 2021 tri herë kishte bërë paralajmërim ndaj qiramarrësve për mos përmbushjen e obligimeve kontraktuale, deri në fund të vitit 2021 nuk ishin ndërmarrë veprime konkrete për shkëputjen e njëanshme të kontratës dhe inicimin e procedurave gjyqësore për mos pagesë të borxhit, siç parashihet me kontratë.

Kjo kishte ndodhur për shkak se Ministria nuk kishte ndërmarrë veprime për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme dhe për shkak të mungesës së përgjegjësisë nga ana e qiramarrësve.

Ndikimi

Mungesa e veprimeve konkrete shtesë për arkëtimin e të arkëtueshmeve rrezikon me humbje financiare për Ministrinë dhe mund të shkaktojë precedent duke ndikuar negativisht në subjektet tjera që ti paguajnë obligimet e tyre me kohë, ndërsa vjetërsia e tyre e vështirëson inkasimin.

Rekomandimi C1

Ministri duhet të siguroj efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, duke ndërmarrë të gjitha masat ligjore për trajtimin e borxheve të vjetra nga dhënia me qira të tokave bujqësore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Ministria)

Më gjerësisht shih Shtojcën I

2.3.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në MBPZhR operon me tre anëtarë të stafit – UD/Drejtori i NjAB-së dhe dy auditorë. Për vitin 2021, kjo njësi kishte hartuar planin vjetor të punës bazuar në planin strategjik ku kishte planifikuar tetë auditime, prej të cilave kishte finalizuar gjashtë auditime të rregullta dhe dy me kërkesë të Menaxhmentit. Po ashtu, në kuadër të MBPZHR operojnë edhe dy Njësi të veçanta të Auditimit të Brendshëm, në AZHB dhe në APK. NJAB në AZHB përbëhet nga dy anëtarë të stafit – Drejtori i NJAB dhe një auditor. Për vitin 2021, kjo njësi kishte planifikuar kryerjen e katër auditimeve, prej të cilave kishte realizuar dy auditime të rregullta dhe një me kërkesë të menaxhmentit. Ndërsa, NJAB në APK operon me vetëm një auditor. Për vitin 2021, kjo njësi kishte planifikuar kryerjen e katër auditimeve, të cilat ishin realizuar në tërësi. Vlen të ceket se për shkak të parregullsive të identifikuara gjatë auditimit të inspektoratit qendror për pylltari dhe gjueti, kjo njësi kishte hartuar dhe një raport për përcjellje.

Çështja A6 - Mos trajtimi i raporteve të auditimit të AZHB dhe APK nga Komiteti i auditimit

Gjetja

Sipas nenit 5.1 të UA MF 01/2019 për Themelimin dhe Funkcionimin e Komitetit të Auditimit në sektorin publik, - Komiteti i Auditimit ndihmon udhëheqësin e subjektit të sektorit publik në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike, me qëllim që të arrihen objektivat e synuara të organizatës, duke ofruar këshilla dhe rekomandime për udhëheqësin e subjektit të sektorit publik që kanë të bëjnë me qeverisjen, menaxhimin e rrezikut dhe proceset e kontrollit të brendshëm. Ndërsa, sipas nenit 7 pika 1.5. Komiteti i auditimit mbikëqyr dhe vlerëson performancën e aktivitetit të auditimit në përmbushjen e planit të miratuar përmes raporteve periodike nga udhëheqësit e Njesisë së auditimit të brendshëm dhe shqyrton raportet përmbledhëse, gjetjet, rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe siguron që ato janë adresuar siç duhet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik.

Komiteti i Auditimit në përbërje prej pesë anëtarësh gjatë vitit 2021 kishte mbajtur pesë takime, në këto takime janë shqyrtuar raportet, gjetjet e NjAB të MBPZhR, rekomandimet dhe progresi i tyre, mirëpo nuk kishte trajtuar dhe përcjellë auditimet dhe punën e NjAB të AZHB dhe APK. Këta të fundit nuk merrnin pjesë as në takimet e Komitetit.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos zbatimit në përpikmëri të kërkesave ligjore për shqyrtimin e menaxhimit të rrezikut dhe të mjedisit të kontrollit të brendshëm nga Komiteti i Auditimit.

Ndikimi

Mungesa e shqyrtimit nga Komiteti i auditimit i punës së dy NjAB të cilat për nga buxheti dhe funksionimi i tyre janë të ndjeshme dhe komplekse rezulton me mungesë të monitorimit të punës të NjAB për AZHB dhe APK, duke mos ofruar mbështetje dhe siguri menaxhmentit në lidhje me efektivitetin e kontroleve kyçe financiare.

Rekomandimi A6

Ministri duhet të sigurojë se roli, puna dhe misioni i KA në Ministri po përmbushet dhe funksioni i auditimit të brendshëm është i monitoruar mirë me qëllim që të arrihen objektivat e synuara të organizatës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Ministria)

Më gjerësisht shih Shtojcën I

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁶	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	61,255,496	78,317,466	74,998,863	69,734,309	54,938,293
Grante Qeveritare – Buxheti	54,986,960	71,935,364	71,157,826	64,104,081	51,029,046
Financimi përmes huamarrjes	2,399,472	2,399,472	1,917,705	4,073,675	3,404,476
Financimi përmes huamarrjes – klauzola e investimeve	3,685,909	3,685,909	1,777,899	1,414,197	12,000
Të bartura nga viti i kaluar	0	113,566	112,342	72,768	0
Të hyrat vetanake	183,155	183,155	33,092	69,589	110,151
Te hyrat nga AKP-ja	0	0	0	0	382,620

Buxheti final ishte më lartë se buxheti fillestar për 17,061,970€ apo rreth 28%. Kjo rritje ishte me vendim të Qeverisë në vlerë prej 19,500,000€ si dhe shfrytëzimit të të hyrave vetanake në vlerë prej 113,565€, ndërsa zvogëlimi i buxhetit kishte ndodhur si rezultat i kursimeve buxhetore nga Ministria e Financave, Transfereve dhe Punës në vlerë prej 2,551,595€.

Në vitin 2021 MBPZhR kishte shpenzuar rreth 96% të buxhetit, nivel i ngjashëm si vitin e kaluar ku shpenzimi ishte 97% të buxhetit. Shpjegimet lidhur me zbatimin e buxhetit dhe të pozicionit aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	61,255,496	78,317,466	74,998,863	69,734,309	54,938,293
Pagat dhe mëditjet	2,891,505	2,469,393	2,468,689	2,595,904	2,619,825
Mallrat dhe shërbimet	2,815,401	2,533,187	2,096,169	3,325,787	3,938,577
Komunalitë	135,660	75,087	72,956	61,003	70,328
Subvencionet dhe transferet	49,477,022	68,639,685	67,989,985	61,643,007	45,768,940

Investimet Kapitale	5,935,909	4,600,113	2,371,064	2,108,609	2,540,622
---------------------	-----------	-----------	-----------	-----------	-----------

MBPZhR kishte lëvizje buxhetore nëpër kategori. Megjithatë, të gjitha lëvizjet/ndryshimet ishin të mbështetura me vendime përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Qeverisë. Sqarimet rreth ndryshimeve buxhetore janë shpalosur si në vijim:

- Buxheti për paga dhe mëditje ishte zvogëluar për 422,112€, si rezultat i Vendimit të Qeverisë nr. 11/52 për shkak të mos plotësimit të pozitave të lira sipas Ligjit të Buxhetit. Shpenzimi në këtë kategori ishte rreth 99% e buxhetit.

- Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 282,214€. Kjo ishte si rezultat i transferit të mjeteve në vlerë prej 184,918€ nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, nga lejimi i shfrytëzimit të të hyrave vetanake të bartura në vlerë prej 113,566€ si dhe në anën tjetër zvogëlim në vlerë prej 580,697€ bazuar në vendimet e qeverisë për kursimeve buxhetore. Shpenzimi në këtë kategori ishte rreth 83% e buxhetit.


- Buxheti final për shpenzime komunale ishte zvogëluar për 60,573€. Ndryshimi kishte ndodhur si rezultat i kursimeve buxhetore nga MF në fund të vitit.

- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 19,162,663€. Rritja kishte ndodhur për shkak të disa përshtatjeve si: ndarja e mjeteve prej 19,500,000€ me vendime të Qeverisë (Vendimi nr. 06/58, 20/50, 09/21), transferit të mjeteve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve prej 184,918€ dhe shkurtimeve buxhetore nga MFTP prej 152,419€ në fund të vitit. Shpenzimi në këtë kategori ishte rreth 99% e buxhetit.

- Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,335,796€. Kjo ishte si rezultat i kursimeve buxhetore nga MFTP. Përkundër zvogëlimit të buxhetit të projekteve, MBPZhR nuk kishte mundur të realizonte më shumë se 52% të buxhetit për investime kapitale. Kjo ka ndodhur për shkak të disa shkaqeve si: lëndëve të cilat aktualisht janë në OSHP, zhvillimit të vonshëm i procedurave të prokurimit në kuadër të marrëveshjeve të bashkëfinancimit me Komunitatet përkatëse dhe mos inicimit të procedurave të prokurimit.

Shpenzimet për menaxhimin e pandemisë Covid 19 në vitin 2021 ishin 19,342,944€. Ato kanë të bëjnë me mjetet e ndara nga Qeveria për zbatimin e programit për rimëkëmbje ekonomike lidhur nën programin “Politikat bujqësore dhe tregjeve” për pagesat direkte për mbështetjen e fermerëve dhe bujqëve.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga MBPZhR në 2021 ishin në vlerë 2,680,064€. Krahasuar me vitin e kaluar kishte rritje të inkasimit të të hyrave për 315,783€ apo 13%. Të hyrat realizohen nga lëshimi i licencave, të hyrat nga qiraja e tokës së dhënë në shfrytëzim, shitja e shërbimeve, etj. Shuma prej 2,271,030€ apo 85% e të hyrave të hyrave totale janë realizuar nga Agjencia Pyjore e Kosovës (APK), ndërsa pjesa tjetër është realizuar nga departamentet tjera. Shuma prej 15,966€ ka të bëjë me kthimin e mjeteve nga viti i kaluar.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	2,082,300	2,515,914	2,680,063	2,364,281	2,328,064
Të hyrat jo tatimore	2,082,300	2,515,914	2,664,098	2,235,803	2,324,319
Të hyrat tjera	0	0	15,966	128,477	3,745

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2020 të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kishte rezultuar në 12 rekomandime. MBPZHR kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, gjashtë (6) rekomandime ishin zbatuar; një (1) pjesërisht, katër (4) rekomandime nuk ishin zbatuar si dhe një (1) rekomandim nuk është i aplikueshëm më. Për më tepër, shih më poshtë Grafikon 2.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri duhet të ndërmarrë veprime për të siguruar regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë siç parashihet me rregulloren Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në mënyrë që gjendja e pasurisë të raportohet në mënyrë të saktë dhe të drejtë.	Ministria nuk kishte implementuar rekomandimin, pasi që edhe këtë vit për pjesën e mbetur të projektit "Konsolidimi dhe Inventarizimi i tokave Bujqësore në Republikën e Kosovës", nuk ishte bërë regjistrimi në regjistrin e pasurive dhe	Nuk është adresuar

			disa nga pronat e IBK ende shfrytëzohen dhe kontrollohen nga IBK. Shih çështjen B1.	
2.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë planifikimin e buxhetit në përputhje me natyrën e projekteve në mënyrë që pagesat të realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.	Edhe këtë vit pagesa për projektin "Konsolidimi dhe inventarizimi i tokave bujqësore në Republikën e Kosovës ishte paguar nga mallra dhe shërbimet, ndërsa për nga natyra është dashur të paguhet nga investimet kapitale. Shih çështjen B2.	Nuk është adresuar
3.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë që me rastin e përgatitjes së PFV zbatohen procedurat adekuate të kontrollit të brendshëm duke verifikuar saktësinë dhe plotësinë e të dhënave për obligimet e papaguara.	Kjo çështje është trajtuar tek baza për opinion A1 - Shpalosje jo të sakta në PVF, së bashku me shpalosjet tjera jo të plota/sakta.	Nuk është i aplikueshëm më
4.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj se respektohen të gjitha procedurat e përcaktuara me rregullore në mënyrë që para procedimit të pagesave, fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja, të pranohet malli/shërbimi dhe në fund të kryhet pagesa.	Gjatë procesit të auditimit për vitin 2021 nuk kemi vërejtur raste ku zotimi dhe urdhërblerja ishin proceduar pas pranimit të faturës.	I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Ministri duhet që me pjesën tjetër të menaxhmentit, në hollësi ta analizojë gjendjen e detyrimeve të krijuara sipas programeve të ndryshme të subvencionimit, dhe të bëj prerjen e gjendjes deri në datën e raportit. Së pari të siguroj se të gjitha grantet, pagesat direkte dhe detyrimet tjera të krijuara më herët, të paguhen, e më pas të krijon obligime të reja ndaj farmerëve.	Edhe këtë vit kemi hasur në vonesa në pagesën e detyrimeve tek mallra dhe shërbimet dhe subvencionet dhe transferet. Shih çështjen B3.	Nuk është adresuar
6.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet t'i rishikoj rastet e mësipërme dhe të siguroj se financimi i fermerëve bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në UA. Kontrollat lidhur me ndarjen e subvencioneve duhet të jenë shumë më rigorozë.	Gjatë auditimit të pagesave direkte për vitin 2021 nuk kemi hasur raste të tilla. Në të gjitha rastet ishte dëshmuar lidhja familjare	I zbatuar

			me dëshmi të afërsisë familjare ose me kontratën për marrjen e tokës me qira.	
7.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të siguroj se programi për subvencione të hartohet dhe miratohet në fillim të vitit fiskal, me qëllim të harmonizimit të tij me ciklin buxhetor, thirrjen për ndarjet vjetore të subvencioneve si dhe ekzekutimin e pagesave brenda vitit, si dhe të përcaktojë kriteret të sakta në program në mënyrë që mbështetja financiare për fermerë të jetë në përputhje me buxhetin e aprovuar vjetor.	Edhe pse në vitin 2021 Programi për Pagesa Direkte është miratuar në korrik të vitit 2021, kjo ishte bërë pas shlyerjes së borxheve të bartura nga viti 2020. PPD për vitin vijues ishte aprovuar në muajin mars të vitit 2022.	I zbatuar
8.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të siguroj se kriteret e përcaktuara në Udhëzim Administrativ zbatohen me përpikëri nga zyrtarët përgjegjës të AZhB-së, dhe të sigurojë se nuk do të kalojë në procesin e vlerësimit asnjë përfitues i cili nuk i ka përmbushë kushtet e kontratës paraprake.	Gjatë auditimit të granteve ne nuk kemi vërejtur raste ku janë përzgjedhur përfituesit të cilët janë në Listën e zezë apo që nuk iu kishte përmbajtur kushteve kontraktuale paraprake me Ministrinë.	I zbatuar
9.	Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë se komisioni i inventarizimit do të bëjë krahasimin e gjendjes së pasurisë sipas raportit të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurisë, të azhurnoj regjistrin me rezultatet e inventarizimit dhe gjendjen e azhurnuar ta prezantoj në PVF.	Ministria kishte bërë inventarizimin e pasurisë për vitin 2021, mirëpo edhe këtë vit nuk kishte arritur që të harmonizoj rezultatet e inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurisë. Shih çështjen B4.	Nuk është adresuar
10.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri duhet të sigurojë që dhënia në shfrytëzimin e tokave bujqësore bëhet në përputhje me kriteret e parapara me ligj, në përputhje me çmimet e tregut, si dhe duhet siguruar që të ndërmerren hapat e nevojshëm lidhur me arkëtimin e të hyrave për dhënien në shfrytëzimin të tyre.	Gjatë auditimit të llogarive të arkëtueshme nuk kemi hasur në raste të tilla ku është bërë ndërrimi i përkohshëm i destinimit të tokave bujqësore. Ndërsa, edhe	Pjesërisht i zbatuar

			këtë vit kemi raste ku nuk është bërë kryerja e obligimeve sipas kontratës nga operatorët dhe Ministria nuk kishte ndërmarrë veprime për inkasimin e borxhit. Shih çështjen C1.	
11.	Obligimet e papaguara	Ministri në bashkëpunim me Qeverinë duhet të sigurojnë fondet e nevojshme për kryerjen e obligimeve të krijuara. Po ashtu Ministri duhet të vendosë kontrollet adekuate për të siguruar se çdo vendim për mbështetje financiare do të bëhet në përputhje me buxhetin e aprovuar.	Qeveria kishte ndarë mjetet e nevojshme për mbulimin e obligimeve për pagesat direkte dhe ishin shlyer obligimet e bartura nga viti 2020. Fillimisht ishin kryer obligimet e mbetura dhe ishte shpallur Programi për pagesa direkte në vitin 2021. Për te paguar pjesën e mbetur të obligimeve që në fund të vitit kanë qenë në fazën e vlerësimit dhe kontrollit administrativ është ndarë buxhet shtesë në vitin 2022.	I zbatuar
12.	Auditimi i Brendshëm	Ministri dhe Kryeshefi Ekzekutiv i AZHB-së duhet të sigurojë që NJAB të jetë funksionale dhe me kapacitete të mjaftueshme në mënyrë që të përfundoj auditimet e planifikuara me planin vjetor të punës dhe që fushëveprimi i NJAB-së të fokusohet në vitin aktual.	Rekomandimi është zbatuar, ngase NJAB e AZHB nga katër raporte të planifikuara për vitin 2021 kishte realizuar dy dhe I treti ishte realizuar në fillim të vitit 2022.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Arian Haxha, Drejtor i Auditimit



Nora Rashiti Nishefci, Udhëheqëse e ekipit



Ajtene Llapashtica, Anëtare e ekipit



Lumturije Sopi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Sqarim rreth Letër Konfirmimit

Pas përcjelljes së draft-raportit të auditimit të MBPZHR për komente, brenda afatit 15 ditësh janë mbajtur disa takime me stafin e Ministrisë si dhe kemi pranuar komente së bashku me dëshmitë përkatëse (për raste të caktuara). Pas analizimit të dëshmimeve janë bërë disa plotësime/ndryshime në përmbajtjen e draft-raportit i cili është përcjellur përsëri tek Ministria.

Pas kësaj, Ministrisë ju është dhënë afat shtesë për të komentuar apo pajtuar me përmbajtjen e verzionit final të draft-raportit të përcjellur mirëpo ministria nuk është përgjigjur. Stafi i ZKA-së në vazhdimësi ka komunikuar me personat përgjegjës në kuadër të Ministrisë për tu informuar me procesin, por pa asnjë përgjigje konkrete. ZKA i ka dhënë edhe një afat shtesë në të cilin e kemi potencuar se nëse nuk kthehet përgjigje ne do të finalizojmë draft-raportin si të tillë.

Në mungesë të përgjigjeve, ZKA ka publikuar raportin e auditimit të MBPZHR për vitin 2021 pa letër-konfirmim apo komente.

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Përfituesi Emine Berani, Masa 101 – Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore 101.2.1 – Sektori i pemëve dhe serrave. Garancioni bankar kishte validitet deri më 10.08.2021 me vlerë 18,000€, ndërsa kontrolla e dytë në terren ishte realizuar më 03.11.2021; Përfituesi Hyrë Bajraktari, Masa 101 – Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore 101.1 Pemë drufutore. Garancioni bankar kishte validitet deri më 18.08.2021 me vlerë 20,000€, ndërsa kontrolla e dytë në terren ishte realizuar më 21.06.2021. Pasi që përfituesi nuk e kishte sjellë panelën solare, është bërë rikontrolli më datë 26.08.2021; Përfituesi Mustafë Hoxha, Masa 103 – Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore. Garancioni bankar kishte validitet deri më 21.02.2022 në vlerë prej 100,000€, ndërsa kërkesa për pagesë është bërë më datë 11.02.2022 dhe kontrolla në teren ende nuk ishte realizuar; Përfituesi Bajram Rrecaj, Masa 103 – Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore 103.3 përpunimi i pemëve dhe perimeve. Garancioni bankar kishte validitet deri më 11.03.2022 me vlerë 99,250€, , ndërsa kontrolla e dytë ishte bërë më datë 15.03.2022.
- ⁵ Raporti i Gjelbërt 2020 është pasqyrë e të dhënave e cila dëshmon punën dhe zhvillimin në sektorin e bujqësisë në Republikën e Kosovës të cilën e ka realizuar MBPZhR-ja.
- ⁶ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.